



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Radio Televizioni i Kosoves  
Drejtor – Mentor SHALA  
Radio KOSOVA 1 dhe Radio Kosova 2  
Rr/Nëna Terezë, p.n.  
Prishtinë

Ref:1609/974/KPM/am

## V E N D I M

*për ripërtëritjen e licencave së transmetimit për Radio Kosova 1 dhe Radio Kosova 2, me seli në Prishtinë*

### Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuele, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës si dhe standardet ndërkombëtare.
2. Radio Kosova 1 dhe Radio Kosova 2 janë pjesë përbërëse e Transmetuesit Publik, që i përket kategorisë me mbulueshmëri nacionale.
3. Radio Kosova 1 dhe Radio Kosova 2 janë licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për transmetimin e radio programeve në territorin e Republikës së Kosovës, me seli në Prishtinë.
4. KPM, me datën 28 gusht 2009, ka marr vendim për dhënien e licencës afatgjatë për Radio Kosova 1 dhe Radio Kosova 2, dhe licencat e KPM-së ishin me afat prej 7 vitesh.
5. Me datën 28 gusht 2016, afati i licencës për Radio Kosova 1 dhe Radio Kosova 2 ka skaduar, ndërsa, në bazë të nenit 25 të Ligjit për KPM-në, kandidati ka të drejtë të kërkojë përtëritjen e licencës nga KPM brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës.

1/2


6. Më 11 gusht 2016, Departamenti i Licencimit, pranë Zyrës Ekzekutive të KPM-së, e ka njoftuar të licencuarin lidhur me obligimet që parashihen me nenin 25, duke e udhëzuar kandidatin që të bëjë kërkesën për vazhdim të licencës, brenda afateve të përcaktuara me këtë nen, si dhe të kryej të gjitha obligimet ndaj tarifës vjetore për licencë të KPM-së.
7. Përfaqësues zyrtar të Radio Kosova 1 dhe Radio Kosova 2 me datën 22 gusht 2016, ka parashtruar kërkesën me shkrim në KPM, për ripërtëritje të licencës.

### Arsyetimi

8. Radio Kosova 1 dhe Radio Kosova 2 janë subjekte transmetuese në kuadër të transmetuesit publik të themeluar me Ligjin nr. 04/l-046 për Radiotelevizionin e Kosovës.
9. Neni 8, paragrafi 2, pika 2 i Ligjit për Transmetuesi Publik parasheh themelimin dhe vënien në funksion të dy radiostacioneve për shërbime audio, në kuadër të Radiotelevizionit të Kosovës.

### V E N D I M

10. Komisioni merr VENDIM për ripërtëritjen e licencës së Radio Kosova 1 dhe Radio Kosova 2, për të ushtruar veprimtari në ofrimin e shërbimeve mediale audio, me interes publik në tërë Republikën e Kosovës.
11. Licenca e transmetimit të KPM-së për Radio Kosova 1 dhe Radio Kosova 2 do të jetë e vlefshme në afat prej 7 (shtatë) viteve, bazuar në Nenin 21, paragrafin 2 të Ligjit për KPM-në, ndërsa, vlefshmëria e licencës do të llogaritet nga data 28 gusht 2016.
12. Të gjitha parametrat e licencës së KPM-së, si: Kategoria e të Licencuarit, Skema Programore, Parametrat Teknik si dhe Harta e Zonës së Mbulimit, mbesin të pandryshuara nga licenca paraprake.
13. Ky vendim hyn në fuqi nga data e nënshkrimit të tij.



Adnan MEROVCI  
Kryetar  
Komisioni i Pavarur i Mediave



19.09.2016  
Data